


| | | | |
|---------------------|-------|---------|-------|
| GLOGOC MUNICIPALITY | | | |
| PRANUAR | 30/08 | 2024 | |
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| MA-400/01- | 42 | 69 | 5 |

RAPORTI I DËGJIMEVE BUXHETORE

BUXHETI I KOMUNËS 2025



Gusht, 2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas –Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit



R A P O R T

I

DËGJIMEVE BUXHETORE

PËR

PROJEKT-BUXHETIN E KOMUNËS PËR VITIN 2025

Gusht, 2024

Hyrje

Buxheti i Komunës së Drenasit për vitin 2025 është 22,133,550€. Komuna vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme (2025-2027) do të përbëjnë afërsisht 91.25% të buxhetit total të komunës. Të hyrat vetanake mesatarisht planifikohet të marrin pjesë në buxhet me 8.75%, prej tyre të hyrat tatimore me 45.59% ndërsa ato jo tatimore marrin pjesë më 54.41%. Vlen të ceket se kufijtë e të hyrave sipas burimeve të financimit të buxhetit komunal janë caktuar me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2025-2027, lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, prill, 2024.

Duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe duke u bazuar në nenin 20 pika 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Qarkores 01/23 dhe Qarkores 02/23 të Ministrisë së Financave, Grupi Punës në koordinim me kryetarin e Komunës së Drenasit z.Ramiz Lladrovci si dhe Zyrën për Komunikim me Publikun, kanë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për organizimin e dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për përgatitjen e buxhetit për vitin 2025.

Përgatitja e raportit është bërë duke u bazuar në nenin 20 pika 1,2,3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna. Në këtë raport mund të gjeni të dhëna që nga mbajtja e dëgjimit publik dhe mënyra e marrjes së kërkesës nga ana e qytetarëve (formë fizike, elektronike dhe në takim direkt të mbajtur në lokalitet).

Me qëllim të informimit të qytetarëve për mundësit buxhetore dhe planifikimet paraprake të ndarjeve buxhetore në projekt buxhetin e komunës për vitin 2024, Grupi Punës në koordinim me drejtoreshën për buxhet dhe financa ka përgatitur një dokument të veçantë me informata të përgjithshme për projekt buxhetin e vitit 2025 duke përfshirë edhe ndarjet fillestare buxhetore të planifikuara. Ky dokument është shpërndarë në kopje fizike për të pranishmit-pjesëmarrës në dëgjimet buxhetore.

Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e vitit 2025

Kryesuese, Albulena Saliuku, Arben Shala- ZK (Anëtar), Milaim Hajdari KK - Drenas (Anëtar), Avdyl Mziu - ZK (Anëtar), Kushtrim Bajraktari - ZKF (Anëtar), Lumnije Krapi- DSHMS (Anëtare), Anita Avdullahu- DBPZH (Anëtare), Petrit Gashi- DPUMM (Anëtar), Agnesë Kastrati Bucolli- DZHE (Anëtare), Laureta Thaqi- DAP (Anëtare), Enkela Dema- DKRS (Anëtare), Muhamet Gjoka - DKA (Anëtar), Endrit Gllareva- DIL (Anëtar), Enver Hoxha- DBF (Anëtar), Bekim Dobra - ZK (Anëtar), Lumturije Kiqina- DSHMS (Anëtar), Vlora Gjinovci- DIL (Anëtar), Nexhmedin Gruda – DSHPE (Anëtar).

Procesi i hartimit të projekt-buxhetit të vitit 2025 i është paraprirë nga hartimi i Kornizës Afatmesme të Buxhetit (KAB) 2025-2027. Grupi Punues, në bashkëpunim me ekzekutivin e komunës dhe Komitetin për Politikë dhe Financa (KPF), ka organizuar gjashtë (6) dëgjime buxhetore. Procesverbalet e këtyre dëgjimeve, në përputhje me kërkesat ligjore, janë publikuar në faqen zyrtare të komunës.

<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/category/degjime-buxhetore/?page=2024>

Në kuadër të ecurisë dhe planifikimit sa më të mirë të dëgjimeve buxhetore, Grupi Punues ka hartuar Planin e Brendshëm të Veprimit për organizimin e dëgjimeve buxhetore 2025, ku janë specifikuar detyrimet ndërinstitucionale me qëllim të organizimit sa më të mirë të dëgjimeve buxhetore.




Foto 1: Foto ilustruese e planifikimit të buxhetit për vitin 2025, e publikuar për njoftimin e qytetarëve.

<https://www.facebook.com/share/bgjfiYdqAbcwsZ8u/?mibextid=WC7FNe>

Në këtë kontekst, është përpiluar edhe kalendari për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, i cili është shoqëruar me ftesa publike dhe informim në kohë për ndryshimet që kanë ndodhur gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore. Ftesat dhe informacionet për organizimin e dëgjimeve buxhetore janë publikuar në faqen zyrtare të komunës, si dhe në mekanizma të tjerë alternativë, të tilla si: platforma e konsultimeve publike në nivel qendror dhe rrjeti social Facebook.

[https://www.facebook.com/komunadrenas/posts/pfbid02xX32JCb1Jk1ubttb2tiFY4qviPd8KgKciEajefrBbxCnmZwARBmnnnM5uJkp8AphI?_cft__\[0\]=AZXcXUBCWxl38otgo347gxp_LZ3RWIPdFml09ahHNxDjW8WUs0Wf0A9HzNt5w0mjVC77cGMOE6kkBc4OfSIDygmVnMbAxLlImkZppUvNwgurK1c3DDZPMD7Fgo00bDIgO5Tlivei7SIH2rSDr-7rG8oHnttY8GNKMVvJbrAQ04Nivx4O_1GJsYM9OL0ONFMCqQF8pAIKK9IJWDK47PRGnTY1&_tn=%2CO%2CP-R](https://www.facebook.com/komunadrenas/posts/pfbid02xX32JCb1Jk1ubttb2tiFY4qviPd8KgKciEajefrBbxCnmZwARBmnnnM5uJkp8AphI?_cft__[0]=AZXcXUBCWxl38otgo347gxp_LZ3RWIPdFml09ahHNxDjW8WUs0Wf0A9HzNt5w0mjVC77cGMOE6kkBc4OfSIDygmVnMbAxLlImkZppUvNwgurK1c3DDZPMD7Fgo00bDIgO5Tlivei7SIH2rSDr-7rG8oHnttY8GNKMVvJbrAQ04Nivx4O_1GJsYM9OL0ONFMCqQF8pAIKK9IJWDK47PRGnTY1&_tn=%2CO%2CP-R)

<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2024/07/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-vitin-2025.pdf>

[Konsultat publike | Konsultimet publike \(rks-gov.net\)](#)

Ndryshe nga vitet e kaluara, këtë vit, kryetari i komunës ka ftuar qytetarët të marrin pjesë në dëgjimet buxhetore përmes një videoje.

<https://www.facebook.com/reel/502063345644743>

Krahas planifikimit të dëgjimeve buxhetore me prezencë fizike, komuna e Drenasit ka synuar që projekti i buxhetit për vitin 2025 të jetë në konsultim edhe përmes formave elektronike, duke u ofruar qytetarëve mundësinë për të pasur qasje në këto dokumente. Për më tepër, Qarkorja Buxhetore 01 është publikuar në faqen e internetit të komunës dhe në platformën e konsultimeve në nivel qendror.


<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/09/Buxheti-i-Komunes-per-vitin-2024-dhe-Parashikimi-i-buxhetiti-2025-2026.pdf>

Grupi punues, në kuadër të ndarjes së përgjegjësisë dhe ndërmarrjes së aktiviteteve për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e konsultimit publik për projekt-buxhetin e komunës, kishte planifikuar shfrytëzimin e databazës së konsultimeve publike për të targetuar grupe të ndryshme qytetare dhe për t'i përfshirë ato në procesin e konsultimeve publike. Në këtë kontekst, grupi punues, përmes Zyrës për Informim, ka informuar grupe të ndryshme qytetare, duke përfshirë: OJQ, biznese, fermerë, ekspertë të fushave të ndryshme, drejtorë shkollash,


përfaqësues të organizatave rinore, organizatave studentore, anëtarë të KKSBB-së, anëtarë të kuvendit të komunës, etj.

Pjesëmarrja

Gjatë dëgjimeve buxhetore, pjesëmarrja ishte relativisht e kënaqshme. Nga gjashtë dëgjime buxhetore në lokacione të ndryshme, numri total i pjesëmarrësve ishte 255: 129 ishin femra dhe 126 meshkuj.



PJESËMARRJA



Kërkesat, sugjerimet dhe komentet e parashtruara ishin kryesisht të natyrës së ngjashme, duke përfshirë: ndriçimin publik, infrastrukturë rrugore (mirëmbajtja, shtrimi dhe asfaltimi i rrugicave dhe trotuareve), ujësjellës dhe kanalizim.

Kërkesat, sugjerimet dhe komentet e paraqitura në formë tabelore:

| Metodat e konsultimit | Data / Kohëzgjatja | Numri i pjesëmarrësve | Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime | Ndarja gjinore | Ndarja mbi bazat gjinore të kërkesave |
|--|--|-----------------------|--|----------------|---------------------------------------|
| Dëgjimi publik në Dobroshec(Dobroshec, Çikatovë e Vjetër, Godanc, Gllanasellë, Likoshan dhe Gradicë) | 29.07.2024 10:30 - 11:30 1 orë | 41 pjesëmarrës | 6 | 21 M 20 F | 6 M 0 F |
| Dëgjimi publik në Tërstenik (Tërstenik I & II, Shtuticë, Poliazhë dhe Verboc) | 29.07.2024 13:20- 14:20 1 orë | 42 pjesëmarrës | 6 | 24 M 18 F | 6 M 0 F |
| Dëgjimi publik në Baicë(Baicë, Abri, Tërdevc, Krajkovë dhe Damanek) | 30.07.2024 10:30 - 11:15 45 minuta | 36 pjesëmarrës | 2 | 13 M 23 F | 2 M 0 F |
| Dëgjimi publik në Arllat (Arllat, Llapushnik, Gjergjicë, Negroc dhe Vuqak) | 30.07.2024 13:20 - 15:00 1 orë e 40 minuta | 47 pjesëmarrës | 7 | 25 M 22 F | 6 M 1 F |
| Dëgjimi publik në Drenas(Drenas I,II dhe II,Shtrubullojë, Gllobar, Poklek i Vjeter, Poklek i Ri dhe Vasilevë) | 31.07.2024 10:30- 11:45 1 orë e 15 minuta | 44 pjesëmarrës | 8 | 20 M 24 F | 6 M 2 F |
| Dëgjimi publik në Komoran(Komoran I, II, III, Zabel i Ultë dhe i Epërm, Korroticë e Ultë dhe e Epërme, Sankoc, Nekoc dhe Kishnarekë) | 31.07.2024 13:20 - 15:20 2 orë | 45 pjesëmarrës | 11 | 23 M 22 F | 10 M 01 F |

Të gjitha kërkesat e parashtruara, sugjerime dhe komentet në takimet fizike si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë tabelore në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Projekt buxheti i vitit 2025, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, do të finalizohet dhe jo me larg se **30 shtator 2024** të miratohet në Kuvendin e Komunës së Drenasit.

| Kategorizimi i kërkesave | Numri |
|---------------------------------|--------------|
| Kapitale | 34 |
| Mallra dhe shërbime | 18 |
| Subvencione | 03 |
| Paga dhe mëditje | 01 |

Shtojca 1 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.

| Temat e dëgjimit buxhetor | Kërkesat / Sugjerimet / Komente* | Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2023 | Statusi i kërkesës/ sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar) | Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm) | Kategorizimi i kërkesave |
|-----------------------------------|---|---|---|--|--------------------------|
| Dëgjimet Buxhetore për vitin 2025 | Ujësjiellësi është pritoritet i yni, 4 rrugë pronë private janë të pashtruara dhe kam kërku nga banorët që të njejtat ti dhurohen komunës në mënyrë që të mund të asfaltohen. Kemi kërkuar edhe trotuarin nga Çikatova e Vjetër deri në Dobroshec dhe prej hekururdhës te kthesa e shkollës deri te stacioni i trenit. Dy rrugica të shtrohen me zhavor. Rruga te Lugu i Besës, projektin e kemi falas, do ta dorëzojmë | Xhevdet Shishani, administrator i fshatit Dobroshec, Çikatovë e Vjetër dhe Godanc- | Pranohet pjesërisht | Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesave erdhi në përfundim se projektet që janë të natyrës së projekteve të përgjithshme si ai i ndriçimit publik janë në proces e sipër dhe se të njejtat do të realizohen në vitin e ardhshëm për të përmbushur kështu një projekt të rëndësishëm për qytetarët e Drenasit. Rrugët të cilat janë pronë publike do të realizohen gjatë vitit 2025 dhe se është detyrim ligjor që ato rrugë që është interes qytetarë të asfaltohen të kalojnë si pronë | Kapitale |

| | | | | | |
|--|---|--|-----------------|---|------------------------|
| | <p>kërkesën bashkë me projekt. Ndriçimi ka përfunduar pjesa më e madhe dhe të vazhdohet pjesa tjetër.</p> <p>Çikatovë e Vjetër: Asfaltim në lagjen Dubovci, urë në lagjen Karaxha dhe fushë sportive në lagjen Morina.</p> | | | <p>publike, në të kundërtën nëse ky proces dështon, asnjë rrugë private nuk do të asfaltohet sepse është e jashtëligjshme. Trotuaret do të analizohen pronësia e tokës në të cilin do të kalojë projekti në fjalë. Nëse ka hapësirë të mjaftueshme publike do të realizohet në varësi të mundësive buxhetore për vitin 2025 që mëpastaj të vazhdohet edhe në vitet tjera.</p> | |
| <p>Dëgjimet Buxhetore për vitin 2025</p> | <p>Rrugica prej mullinit të shtrohet një pjesë zhavor si dhe një fushë sportive në oborr të shkollës. Vazhdimi i murit Godanc-Gllanasellë rreth 15m gjatësi. Poashtu tre gypa të kanalizimit janë blloku dhe mundësisht të lirohen.</p> | <p>Qerim Berbatovci, përfaqësues i Godancit</p> | <p>Pranohet</p> | <p>Grupi punues gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesave nga përfaqësuesi në fjalë ka ardhur në përfundim që kërkesat pranohen sepse nuk kanë kosto të lartë buxhetore dhe do të realizohen gjatë vitit të ardhshëm.</p> | <p>Kapitale</p> |

| | | | | | |
|--|--|--|-----------------------------|---|------------------------|
| <p>Dëgjimet Buxhetore për vitin 2025</p> | <p>Prioritet kemi kanalizimin te lagja Dibrani. Të asfaltohet rruga te lagja Maliqi sepse është shumë e dëmtuar. Te vazhdohet pjesa tjetër e ndriqimit. Lagja Fazliu të lidhet me lagjen Dervishi dhe ne lagjen Selmani rruga të shtrohet me zhavor. Rregullimi i rrethojës së shkollës ka përfundu dhe asnjëherë nuk ka përfundu. Gjithsejt janë 900m rrugë për asfalt tek lagjet Dervishi dhe Uka. Likoshan, lagjja Gjeli dhe tek gjashte lisat te asfaltohet rruga rreth 1200m gjatesi.</p> | <p>Hafiz Muja, përfaqësues i Gradicës</p> | <p>Pranohet</p> | <p>Grupi punues në konsultim me gjithë anëtarët e drejtorive përkatëse erdhi në përfundim se projektet në fjalë nuk kanë kosto të lartë buxhetore dhe se njëkohësisht disa projekte si ai i ndriçimit publik janë në realizim e sipër, kësisoji këto projekte pranohen, përveç nëse rrugët janë në pronë private atëherë realizimi i projektit të asfaltimit është i pamundur sepse është joligjor.</p> | <p>Kapitale</p> |
| <p>Dëgjimet Buxhetore për vitin 2025</p> | <p>Kërkojmë trotuar nëpër gjithë fshatin. Ndriçimi ka përfundu por vetëm 4-5 shtylla</p> | <p>Muhamet Kurrumeli, përfaqësues i Gllanasellës</p> | <p>Pranohet pjesërisht.</p> | <p>Pas kërkesës në fjalë Grupi Punues ka rënë dakord që top prioritet është ujësjellësi dhe se</p> | <p>Kapitale</p> |

| | | | | | |
|--|---|--|----------------------------|---|------------------------|
| | <p>janë të papërfunduara. Fshati ka nevojë për ujësjellës. Rrugët e ndërtuara të mirëmbahen sepse lisat janë shumë të rritur dhe duhet të krasiten. Asfalt ne lagjet Krasniqi dhe Kurrumeli</p> | | | <p>projekti do të prit të përfundojë gjatë vitit 2025 që njëherit të bëhet zgjidhje për ujë të pijes për qytetarët e asaj zone. Projekti i trotuareve do të vazhdojë porsa të përfundojë projekti i ndriçimit publik në atë zonë. Kurse projektet e asfaltimit të rrugëve do të kryhen në varësi të mundësive sepse janë në proces por që duhet presim të kryhen secila më radhë, normalisht ato që janë në pronë publike. Kërkesat tjera do të kryhen nga drejtoria e Shërbimeve Publike nëpërmjet kompanisë "Pastrimi".</p> | |
| <p>Dëgjimet Buxhetore për vitin 2025</p> | <p>Prindërit e fëmijëve të shkollës sonë kanë kërkuar ndriçim për fushë sportive. Të asfaltohet rruga nga shkolla deri te</p> | <p>Arsim Avdyli, drejtor i shkollës</p> | <p>Pranohet pjesërisht</p> | <p>Grupi punues, përkatësisht anëtarët e grupit nga drejtoria e Arsimit në Komunën e Drenasit kanë analizuar kërkesat</p> | <p>Kapitale</p> |

| | | | | | |
|-----------------------------------|---|---|----------|---|---|
| | lagja Avdyli sepse e lehtëson qasjen e fëmijëve në shkollë. Rruga nga shkolla deri te kyqja e rrugës nuk ka shtylla dhe nëse ka mundësi të bëhet ndriçimi së bashku me vendosjen e shtyllave. | | | e bëra nga drejtori i shkollës, kësajsoji kanë rënë dakord që kërkesa për ndriçim për fushë sportive është e mundshme dhe do të realizohet. Rruga tek shkolla deri tek lagja Avdyli do të realizohet në varësi nga mundësitë buxhetore. | |
| Dëgjimet Buxhetore për vitin 2025 | Të bëhet renovimi i shkollës si dhe largimi i kontejnerit nga oborri i shkollës. | Ilir Nika, drejtor i shkollës në fshatin Gllanasellë | Pranohet | Grupi Punues shtjelloi çështjet e ngritura nga drejtori i shkollës theksoi që kërkesat e bëra nga drejtori i shkollës janë të arsyeshme dhe se do të bëhen renovimet e nevojshme në këtë shkollë në vitin 2025, por që do vazhdojnë edhe në vitet e ardhshme për shkak të limiteve buxhetore. | Mallra dhe shërbime&Kapitale |
| Dëgjimet Buxhetore për vitin 2025 | Fshati ka kërkesë për trotuar, kanalizim si dhe disa rrugica të paasfaltuara. Ndriçimi ende | Bajram Qallapeku, administrator i fshatit Tërstenik | Pranohet | Çdo rrugë publike Grupi Punues ra dakord që të jetë prioritet të asfaltohet sepse duke paraparë | Kapitale |

| | | | | | |
|-----------------------------------|---|--------------------------|----------|---|-----------------|
| | është i papërfunduar tek lagjet Dvorani dhe Arllati. | | | punët që janë kryer dhe planifikimet buxhetore, ka mundësi që shumica prej tyre do të mund të kryhen. Kësisoj rrugicat apo rrugët dytësore do të mund të kryhen gjatë vitit të ardhshëm por edhe në këtë vit gjatë rishikimit të buxhetit nëse të njëjtat janë pronë publike. Pra kërkesat pranohen nga Grupi Punues. Trotuaret do të fillojnë së implementuari porsa të përfundojë projekti i ndriçimit publik sepse janë me një kod buxhetor. | |
| Dëgjimet Buxhetore për vitin 2025 | Rruga "Islam Qallapeku" vetëm gjysma është ndriçuar. Sipas mundësive të ndriçohet edhe pjesa tjetër. Te varrezat të shtrohet zhavor sepse po kemi | Rexhep Qallapeku, | Pranohet | Grupi Punues pasi analizojë kërkesat ra në dakordim që kërkesat janë të arsyshme dhe janë brenda mundësive buxhetore. Kësisoji këto projekte do të | Kapitale |

| | | | | | |
|-----------------------------------|---|---|----------------------|--|---|
| | vështirësi për qasje. | | | realizohen në vitin 2025. | |
| Dëgjimet Buxhetore për vitin 2025 | Kërkojmë ndriçim të lagjeve Bilalli dhe Syla, fushë sportive në shkollë të Verbocit si dhe një parking te shkolla. | Islam përfaqësues i Shtuticës | Pranohet | Grupi punues pas analizimit të kërkesave të parashtruara nga përfaqësuesi i fshatit Shtuticë ra dakord që kërkesat janë të arsyeshme dhe kanë kosto jo të lartë buxhetore, që si rrjedhojë edhe pranohen për tu implementuar. | Mallra dhe shërbime&Kapitale |
| Dëgjimet Buxhetore për vitin 2025 | Kemi dhjetë kërkesa: ujësjellës, kanalizim, 350 m asfalt(rrugë e gatshme me zhavor), rrugica në pronë publike, ndriçim, kanalizimi të lidhet me kolektor, trotuar, parking te varrezat si dhe pajisje të ekonomive familjare me kontenjer për mbeturina. | Arbnor Istogu, përfaqësues i Polluzhës | Pranohet pjesërisht. | Grupi Punues njofton se Projekti i Ujësellësit është duke vazhdu në kyqjen shtëpiake në fshatin Polluzhë. Ndërsa kanalizimi dhe asfaltimin gjithashtu dhe ndriçimi publik do të vazhdojnë në vitin 2025. Kërkesat tjera do të realizohen në varësi të mundësive buxhetore. | Kapitale&Mallra dhe shërbime |
| Dëgjimet Buxhetore për vitin 2025 | Parking të shkollës, ulëse në oborr të shkollës si dhe vendosja e | Burim Istogu, drejtor i shkollës | Pranohet | Anëtarët e Grupit Punues nga Drejtoria e Arsimit pas | Mallra dhe shërbime&Kapitale |

| | | | | | |
|-----------------------------------|--|--|----------------------|--|----------------------------|
| | ndonjë kontenjeri të mbeturinave afër shkolles. | | | kërkesave të parashtruara nga drejtori i shkollës Burim Istogu, ranë dakord që janë kërkesa të arsyeshme dhe se të njëjtat nuk kanë kosto të lartë buxhetore, kësisoji edhe pranohen si kërkesa. | |
| Dëgjimet Buxhetore për vitin 2025 | Nxemja qendrore e shkollës nuk është funksionale. Krahu i djatht i shkollës nuk ka nxemje si dhe të shtrohet rruga me zhvor nga hymja deri te depoja sepse po kemi vështirësi për bartje të druve. | Puntori teknik i shkollës | Pranohet | Grup Punues ka analizuar kërkesat në fjalë dhe ka ardhë në përfundim që janë kërkesa të arsyeshme të cilat do të gjejnë zbatim në vitin e ardhshëm. | Mallra dhe shërbime |
| | | | | | |
| Dëgjimet Buxhetore për vitin 2025 | Përrshëndetje të gjithëve, fshati Baicë ka përjetuar progres të rëndësishëm gjatë këtij viti, me disa projekte të përfunduara dhe të tjera në proces. Kërkesë për ndërtimin e një fushe sportive për | Semedin Kiçina, Administrator i fshatit Baicë | Pranohet pjesërisht. | Grupi Punues ka shqyrtuar kërkesën e administratorit Kiçina kësisoj kanë ardhur në përfundim se ndërtimi i fushës sportive përveç koston së ndërtimit ka kosto edhe të mirëmbajtjes dhe | Kapitale |

| | | | | | |
|-----------------------------------|--|---|----------|--|---|
| | shkak të madhësisë së fshatit dhe nevojës për investime të tilla. Sugjerim për ndërtimin e një rrethrotullimi ose zgjerimin e rrugës në kthesën drejt Abrisë. | | | se me një vendim të kryetarit është paraparë që të shfrytëzohen të fushat sportive të shkollave nga të rinjtë nëpër lokalitetet përkatëse. Për rrethrotullim duhet të shikohen kushtet teknike të rrugës dhe kjo merr kohë por që do të njoftohen gojarisht për zgjerimin në fjalë. | |
| Dëgjimet Buxhetore për vitin 2025 | Përhëndetje për të gjithë. Problemet me furnizimin me ujë mbeten një sfidë kryesore në këto fshatra. Një takim me përfaqësues të KFOR-it ka rezultuar me premtime për ndërhyrje, dhe kërkohet mbështetja e komunës për procedurat e mëtejshme. Kërkesë për ndriçim në lagjen Behrami, ku shtyllat janë të betonit. | Arben Haziri, administrator i fshatrave Krajkovë dhe Damanek | Pranohet | Grupi Punues pasi diskutuan rreth kërkesave në fjalë u dakorduan që kërkesat për furnizim me ujë të pijes janë kërkesa me prioritet të lartë për qeverisjen lokale. Kësisoj do të merren parasysh të gjitha kërkesat dhe do të realizohen në afat sa më të shkurtër të mundshëm. Njëkohësisht ndriçimi publik është projekt që | Mallra dhe shërbime&Kapitale |

| | | | | | |
|------------------------------|---|---|----------------------|---|--|
| | | | | është duke u vazhduar të implementohet. | |
| Projekt buxheti i vitit 2024 | Të funksionalizohet qerdhja e fëmijëve . Puntori teknik nga ambullanta është hjek. Poashtu edhe analizat janë hjek nga kjo AMF. Ndriqim në lagjen e xhamisë, te Faniqt dhe Bytyqt. Poashtu edhe Gjergjica është pa ndriqim. Kemi problem me mbyllja të kanalizimit, brenda mundësive të ndrohen gypat dhe kanalizimi të lidhet me kolektor. Te lagjja Faniqi të ndërtohet gropa septike sepse kanalizimi del ne ara. Te Bytyqt të ndrohet gypi i kanalizimit. Rruga te lagjja e xhamisë ka mbetë në gjysmë. | Shumzim Bujupi, Administrator i Arllatit | Pranohet pjesërisht. | Grupi punues ka diskutuar rreth kërkesave në fjalë dhe ka njoftuar se për punëtorin teknik nuk ka injete të mjaftueshme në dispozicion sepse pavarësisht kërkesave kemi buxhet tejet të limituar dhe se mungon mbështetja nga niveli qendror. Ndriçimi publik do të vazhdojë të realizohet dhe se ky projekt është në implementim e sipër në gjithë territorin e komunës së Drenasit. Projektet e kanalizimit do të realizohen sepse janë projekte në prioritet për qeverisjen lokale. Njëkohësisht do të analizohen veprimet që do të ndërmerren tek lagja Foniqi. Tek lagjja Bytyqi do të intervenohet në | Paga dhe mëditje Mallra dhe shërbime Kapitale Subvencione |

| | | | | | |
|------------------------------|--|---------------------|---------------------|---|-----------------|
| | | | | rrjetin e kanalizimit kurse do të intervenohet edhe tek rruga e xhamisë. | |
| Projekt buxheti i vitit 2024 | Kemi problem me kanalizim i cili është ndërtuar keq dhe gypat janë joadekuat. Ujërat e zeza ma kanë infektu bunarin. | Hysni Bujupi | Pranohet pjesërisht | Grupi Punues pas shtjellimit të kërkesës në fjalë erdhi në përfundim se do të shikohet mundësia e intervenimit në kanalizim dhe se do të angazhohet kompania që ka kontratën përkatëse të vlerësojë problemin. | Kapitale |
| Projekt buxheti i vitit 2024 | Katër rrugë janë me ndriçim të pjesshëm, rotuar rreth 1 km, të bëhet renovimi i rrugës sepse është prish nga kamionat, kanalizim rreth 800 m, rrethojat për dy palë varreza. | Burim Gashi | Pranohet pjesërisht | Grupi punues pas komentit të qytetarit njofton se projekti i ndriçimit do të realizohet gjatë vitit 2025 si dhe do të shikohen mundësitë e intervenimit në rrugët e parashtruara si kërkesë për rregullim dhe ndërtim të ri. Kanalizimi do të ndërtohet nëse nuk ka fare, kurse rrethojat e varrezave janë në proces të | Kapitale |

| | | | | | |
|------------------------------------|--|---|------------------------|--|--|
| | | | | implementimit vetëm se duhet pritur deri sa të i vijë radha lokalitetit tuaj. | |
| Projekt buxheti i vitit 2024 | Të asflatohen rrugë Haki Krasniqi dhe Pllumbat e lirisë. Ndriçimi dhe kanalizimi janë kryer rreth 90% dhe të vazhdohet pjesa tjetër. Të hapet kanali kullues ne rrugë Begzat Krasniqi. Ti hapet dera fushës sportive në oborr të shkollës. | Xhevdet Krasniqi, përfaqësues i Negrocit dhe Vuqakut | Pranohet pjesërisht | Grupi punues pas analizës së kërkesës në fjalë ra në dakordim që një kërkesë e tillë do të realizohet sepse rrugët janë prioritet për qeverisjen lokale dhe se ndriçimi publik është ndërtim e sipër, njëjtë sikurse edhe kanalizimi. Kurse sa i përku kanalit kullues do të shqyrtohet nga ekspertët përkatës. | Kapitale Mallra dhe shërbime |
| Projekt buxheti i vitit 2024 | Lagjja jonë është pa ndriçim dhe kanalizim. Të vendoset gropa septike te ura. Shtyllat e rrymës janë të vjetruara. Poashtu kërkojmë trotuar nga lagjja jonë deri te shkolla. | Blerim Gashi, përfaqësues i lagjes Foniqi | Pranohet pjesërisht | Grupi punues pas analizës së kërkesës së bërë erdhi në përfundim se kërkesat në fjalë janë të arsyeshme dhe njofton se do të realizohen. Kurse për gropën septike do të adresohen tek ekspertët që të vlerësojnë zgjidhjen e duhur. Për shtylla | Kapitale |

| | | | | | |
|--|---|--|---------------------|--|-----------------|
| | | | | elektrike kërkesën duhet drejtuar për tek KEDS. Trotuaret nëse ekziston prona publike janë të mundshme të realizohen sepse lehtësojnë jetën e qytetarëve tanë. | |
| | Duhet të vlerësojmë ato projekte të cilat janë kry. Në secilen lagje është kryer ndonjë projekt. Përkundër kësaj është e natyrshme që ka edhe kërkesa të reja për investime. Kërkojmë trotuar rreth 1200m, ndriçimi të vazhdohet aty ku ka mbetur pa përfunduar. Ujësjetësin si lagje e kemi ndërtuar vetë dhe e kemi shkatërruar vetë me kyqje ilegale. Kërkojmë që të na ndihmoni me ja ndryshu gypit kahjen(600 m gyp). | Dervish Bytyqi, përfaqësues i lagjes Bytyqi | Pranohet pjesërisht | Grupi punues pas analizës së kërkesave të bëra erdhi në përfundim se projektet të ujësjetësit do të ndihmohen në rregullimin e gypit gjatë vitit 2024-2025, dhe rregullimin e ndriçimi publik. Kërkesat tjera do të shqyrtohen gjatë vitit 2025. Kurse sa i përket kërkesës për trotuar do të shikojmë mundësinë duke filluar nga prona se a është publike apo private. Nëse ka pronë publike atëherë sipas mundësive buxhetore do të tentojmë të realizojmë | Kapitale |

| | | | | | |
|--|---|---|---------------------|---|---|
| | | | | projektin e trotuareve. | |
| | Kërkojmë rrethojë të shkollës dhe kënd të lojrave. | Valentina Leku- Gashi, | Pranohet | Grupi punues pas analizës së kërkesës në fjalë ra dakord që një kërkesë e tillë është e arsyeshme dhe se do të realizohet gjatë vitit në vijim. | Mallra dhe shërbime |
| | Ju përgëzoj për punën e posaqërisht për dhënie e objektit në shfrytëzim për hapjen e stacionit policor ne Komoran. Kërkojmë që të hapet edhe stacioni zjarrfikësve, rregullimin e rruges nga tregu i kafshëve deri te lagjja Nishori me gjatësi rreth 1km, rrethrotullim te ambullanta | Naim Krasniqi, përfaqësues i Komoranit I | Pranohet pjesërisht | Grupi punues njofton se nga tregu i kafshëve deri tek lagja Nishori është duke u ndërtuar. Sa i përket rrethrotullimit tek ambullanta është rrugë regjionale dhe i takon ministrisë së Infrastrukturës. Komuna ka bërë disa herë kërkesë për lejim në intervenim por që nuk kemi marrë aprovim nga ministria. Sa i përket stacionit të zjarrfikësve duhet të kemi mjete tjera në dispozicion që të realizojmë një projekt të tillë dhe si projekt është i varur nga niveli qendror. | Mallra dhe shërbime Subvencione Shërbime |

| | | | | |
|--|--|----------------------------|---|--|
| <p>Kërkojmë trotuar për Sankoc dhe Fushticë të Epërme, të vazhdohet pjesa tjetër e ndriqimit, rrugica në lagjen Gjoshi- një kanal kullues rreth 40 m, të asflatohen disa rrugica ne lagjet Pirraku, Lika, Jusufi, Rama dhe Ajazi, të lidhet rruga Mirenë- Fushticë e Ultë. Kemi probleme me ujë sepse rrjeti nuk mirëmbahet nga kompania e ujësjellesit, një pompë e prishur qe disa muaj. E kemi burimin e fshatit ne Golesn, na ndihmoni të kyqemi.</p> <p>Për Fushticë të Ultë kerkojmë të asfaltohen 3 rrugica në lagjen Shabani, 2 rrugica në lagjen Bahtijari, dritat te shkolla si dhe një parking për shkollë.</p> | <p>Kadri Ajazi, Administrator i Sankocit, Fushticës së Ultë dhe Fushticës së Epërme</p> | <p>Pranohet pjesërisht</p> | <p>Ndriçimi publik do të realizohet në vitin në vazhdim edhe këtë vit është duke u realizuar në lokalitete të ndryshme. Sa i përket trotuareve do të shikohet mundësia aty ku ka pronë publike dhe do të mundësohet realizimi i projekteve në fjalë në varësi prej mundësive buxhetore. Aty ku ka prona publike do të vazhdohet të realizohen projektet e asfaltimeve të rrugicave. Projekti i parkingut tek shkolla do të shikohet si mundësi të intervenohet dhe të realizohet si projekt. Sa i përket problemeve të cekura me ujë do të kontaktojmë edhe Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" që të ndërmerren masat e nevojshme për</p> | <p>Kapitale</p> <p>Mallra dhe shërbime</p> <p>Subvencione</p> |
|--|--|----------------------------|---|--|

| | | | | | |
|--|---|--|----------------------------|---|------------------------|
| | | | | sajimin e problemeve. | |
| | <p>Ndriçim, 3 rrugica të asflatohen, rruga Amrush Ferizi e cila është shpronësuar, rruga Neboh Hamiti të shtrohet me zhavor si dhe të emërtohet një rrugë e cila ska emër. Kanalizimi tek nënkalimi të lidhet ne pusetë si dhe të ndërtohet rrjeti i ri i kanalizimit për 7-8 familje. Rrugë për një familje e cila detyrohet të kaloj nëpër oborr të shkollës.</p> | <p>Izet Bytyqi, përfaqësues i Fushticës së Epërme</p> | <p>Pranohet pjesërisht</p> | <p>Grupi punues njofton se ndriçimi është në proces e sipër. Rrugicat nëse janë në prona publike sipas mundësive buxhetore do të realizohet secila por që nëse nuk janë qytetarët që duan asfaltimin e tyre duhet të i bartin si pronë publike. Rrugët me zhavor do të kryhen sepse ekziston një mundësi e tillë. Sa i përket projekteve të kanalizimit do të shikohet nga ekspertët e fushës dhe varësisht prej rekomandimeve të tyre edhe do të veprohet tek to. Rrugë për familje që detyrohet të kalojë nëpër oborr të shkolles, kjo kërkesë duhet të vlerësohet dhe të shikohet qartë se ku qëndron problemi dhe varësisht prej tij të</p> | <p>Kapitale</p> |

| | | | | | |
|--|---|---|---------------------|--|---|
| | | | | merren masat e nevojshme. | |
| | Kanali kullues te xhamia rrezik nga vërshimet, trotuar, ndriqim, si dhe kanalizim në 2 pjesë të shkurtëra. Të asfaltohet rruga Fehmi Bajraktari-Kastrati. | Ymri Bajraktari, administrator i Kishna | Pranohet pjesërisht | Grupi punues thekson se pa një analizë të mirëfilltë nga ekspertët e fushës nuk mund të premtton kanale kulluese, kësisoji thekson se do angazhohen ekspertët që të vlerësojnë mundësitë për projekte që do të pamundësojnë vërshime të lokaliteteve. Rruga “Fehmi Bajraktari dhe Kastrati” sipas mundësive buxhetore do të asfaltohen gjatë vitit të ardhshëm. | Kapitale |
| | Rregullimi i parkut” Pishat e Komoranit”, Asfaltime gjithsejt 2200 m ne rruget Anton Ceta 150m, Miloti 210m, Alban Halilaj 220m, Avdullah dhe Bajram Cakaj 230m, Mentor Ibriqi 170m, Xhaladin Gashi 270m, Elez Zogu | Besim Nishori-Administrator i Komoran I dhe II | Pranohet pjesërisht | Grupi punues njofton se tri segmente që janë parashtruar në kërkesë janë duke u realizuar në teren tani “Alban Halilaj”, “Avdullah dhe Bajram Cakaj” si dhe “Mentor Ibriqi”, projektet te tjera do te shqyrtohen gjate | Kapitale Mallra dhe shërbime |

| | | | | | |
|--|--|--|--|---|--|
| | <p>200m, Avdullah Cakaj 420m, Nazmi Gashi 200m.</p> <p>Ndriqim gjithsejt 1710 m në rrugët Xhaladin Gashi 460m, Fazli Graicevci 700m, Elez Zogu 200m, Nazmi Gashi 200m, Avdullah Cakaj 150m</p> <p>Trotuar gjithsejt 1800m në rrugët Mentor Ibriqi 1200m, Fazli Graicevci 300m dhe Ali Lladrovci 300m.</p> <p>Kamera të sigurisë në qendër të Komoranit, shqyrtim të kërkesave për emërtim të rrugëve si dhe rregullim të kanalit kullues në rrugën Bali Zogu</p> | | | <p>vitit 2025.</p> <p>Projektet tjera të së njëjtës natyrë do të realizohen në varësi prej limiteve buxhetore por që të gjitha këto me radhë do të implementohen edhe në vitet vijuese. Kamerat e sigurisë njëherë janë vendosur por pas refuzimit të Policisë së Kosovës që ato të i marrin në mbikqyre, ky projekt kishte dështuar. Me realizimin e projektit të Stacionit të Policisë është mundësia të funksionalizohet ky projekt. Për emërtimin e rrugëve është komisioni i veçantë i cili merret me to dhe se kërkesa duhet të përcjellet tek anëtarët e komisionit.</p> | |
|--|--|--|--|---|--|

| | | | | | |
|--|--|--|----------------------------|---|--|
| | <p>Rruga nga shkolla tek lagja e lugut janë nal punimet qe 2 apo 3 vjet, trotuar prej rrethrotullimit deri në kufi me Lipjan. Nga lagja Lugu rrjetin ujërat e zeza deri te toka bujqësore të cilat kanë mbetur të papunuara.</p> | <p>Habib Gashi, përfaqësues i Nekocit</p> | <p>Pranohet</p> | <p>Projektet do të realizohen varësisht prej mundësive buxhetore aty ku ka prona publike do të ndërtohet edhe rruga por edhe trotuari. Njëkohësisht edhe rrjeti i kanalizimit do të ndërtohet aty ku nuk ka rrjet të kanalizimeve por që këto projekte janë projekte që ndërtimi i tyre përfshin një periudhë disa vjeçare.</p> | <p>Kapitale</p> |
| | <p>Janë kryer shumë punë në fshatir tonë dhe tani kemi nevojë për një park të lojërave.</p> | <p>Fitore Senu Shabani, Korroticë e Epërme</p> | <p>Pranohet</p> | <p>Grupi punues pas analizimit të kërkesës në fjalë ra dakord që të mundësohet realizimi i projektit të një parku të lojërave por që duhet të gjindet vendi ku të implementohet projekti.</p> | <p>Shërbime, projekt rekreativ</p> |
| | <p>Trotuar mirëpo prona është private, asfaltim 2 rrugë, rruga te varrezat, kanalizim rreth 150m.</p> | <p>Fahredin Hajdini, përfaqësues i Zabelit të Epërm</p> | <p>Pranohet pjesërisht</p> | <p>Grupi punues njofton se në prona private nuk mund të ndërhyhet sepse është e jashtëligjshme. Kërkesat për asfaltim nëse janë</p> | <p>Kapitale</p> |

| | | | | | |
|--|--|----------------------------------|-----------|--|-------------------------------------|
| | | | | prona publike do të realizohen si dhe njëkohësisht projekti i kanalizimit do të vlerësohet mundësia e kyqjes në projektin e kanalizimit përkatës. | |
| | Legalizim të shtëpive të ndertuara në tokë bujqësore, ndriqim, asfalt, trotuar si dhe ulëse përgjatë trotuarëve. | Rexhep Zogu, Komoran | Refuzohet | Grupi punues konstaton se legalizimi i shtëpive të ndertuara në tokë bujqësore është proces i ndërlikuar për të cilin nevojitet leje nga niveli qendror i cili mund të ndryshojë këtë zonë me ligj të veçantë dhe të na mundësojë edhe neve si qeverisje lokale ndëryhyrje. Njëherit edhe ndërtimi i projekteve përcjellëse është i ndërlidhur me të sepse duhet tentuar të gjejmë zgjidhje sesi të na mundësohet ndërhyrja tek këto projekte. | Mallra dhe shërbime Kapitale |
| | Dy rrugica nga 100m si dhe | Halil Bashota, Komoran II | Pranohet | Grupi punues konstaton se | Kapitale |

| | | | | | |
|--|---|---|---------------------|---|---|
| | emërtim të rrugëve sekondare. | | | projektet do të realizohen gjatë vitit 2025. | |
| | Kanalizimi ka mbetur mbi tokë në lagjen Obrija. | Avdullah Cakaj-Komorani II | Pranohet | Grupi punues konstaton se projekti i kanalizimit do të ketë ndëryhyrjen e duhur që të evitohen rrjedhjet nga ai rrjet i kanalizimeve. | Mallra dhe shërbime |
| | Kanalizimi tek rruga kryesore për Skënderaj, ti bëhet një zgjidhje sepse po na shkakton shumë probleme. Ndriqim nëpër lagje për afërsisht 100 drita. Ura për te parku në Kamenicë të zgjerohet sepse shume e ngushtë dhe problem për vizitor. 5 shtëpive te Ibër Lepenci tu mundësohet kyqja në rrugë . | Murat Elshani, administrator i Gllobarit | Pranohet pjesërisht | Grupi punues konstaton se tek rrjeti i kanalizimit që është theksuar ka pasur probleme gjatë intervenimit por që do të tentohet të intervenohet përsëri që të sajohen problemet e paraqitura. Ndriçimi publik do të realizohet gjatë vitit që vjen sepse është projekt në implementim e sipër. Tek kërkesa për kyqje në rrugë për 5 shtëpitë që ndahen nga rrjeti i ujit të Ibër Lepencit do të vlerësohet gjendja në terren dhe të i | Mallra dhe shërbime Kapitale |

| | | | | | |
|--|--|---|---------------------|---|---|
| | | | | bëhet zgjidhje adekuate. | |
| | Për kanalizim nuk është dashur të pyetet Dastan Qallapeku sepse është rruga e komosacionit nga ku kanë mundur të kalojnë gypat, të qpolet asfalti dhe të kaloj në arën time. | Nasuf Elshani, Gllobar | Koment | Nuk ka koment... | Mallra dhe shërbime |
| | Vasileva ka nevojë ndriçim, asfalt dhe ujë. Pokleku i vjetër ka nevojë për një vig dhe asgjësim te gropës septike. Pokleku i ri për një fushë sportive. | Zekë Kluna, Administrator i Vasilevës dhe Poklekut | Pranohet pjesërisht | Grupi punues konstaton se kërkesat në fjalë janë të arsyeshme dhe të zbatueshme kësisoji pranohen. Pokleku i Vjetër do të ketë "vigun" e shumëkërkuar dhe do të intervenohet për të asgjësuar gropën septike. Kurse sa i përket fushës sportive duhet të shfrytëzohet fusha sportive e shkollës sepse ka vendim që të shfrytëzohen ato fusha që të mos ketë nevojë për ndërtim të fushave të reja të cilat do të kenë kosto të re të mirëbajtjes. | Mallra dhe shërbime Kapitale |

| | | | | | |
|--|---|---------------------------------------|---------------------|--|----------------------------|
| | Tri rrugica të pashtuara të cilat janë pronë private mirëpo jemi të interesuar ti kthejm pronat në pronë komonale në mënyrë që ju të mund të investoni. | Ragip Elshani, Gllobar | Refuzohet | Atëherë kur të kthehen në pronë publike do të shqyrtohet edhe si mundësi investimi në të kundërtën e kemi të pamundur të ndërhyjmë. | Kapitale |
| | Rruga 500 m është shtruar me zhavor mirëpo ende nuk është asfaltuar, kur do të shtrohet? | Egzona Tërdeci, asambleiste | Pranohet | Grupi punues konstaton se kjo rrugë do të ndërtohet gjatë vitit 2024-2025. | Kapitale |
| | Kërkojmë ndërtimin e një fushe sportive si dhe trotuar në gjatësi prej 200-250 m përgjat rrugës Nystret Halilaj. | Zahrie Podrimçaku, Poklek i Ri | Pranohet pjesërisht | Grupi punues njofton se fushat sportive janë zor të realizueshme kur afër ka shkolla që janë të pajisura me fusha sportive sepse ekziston vendim që të shfrytëzohen ato objekte sportive për të rinjtë e lokaliteteve. Sa i përket projekteve të trotuareve duhet të shikohet se a ka pronë publike për shfrytëzim për të ndërtuar trotuare, nëse ka do të realizohet. | Kapitale |
| | Parkingu te blloku i kuq të bëhet | Habib Tahiraj, | Pranohet pjesërisht | Grupi punues njofton se është në | Mallra dhe shërbime |

| | | | | | |
|--|---|---|----------------------------|--|------------------------|
| | <p>prapë me pagesë, shkollë të re në Drenas ose Shtrubullojë, ndriçim në disa rrugica, vendkalimi për këmbësor tek rruga e zgjeruar te rrethi, mirembajtje për Qendër Rinore.</p> | <p>administrator i Drenas I</p> | | <p>projekt ndërtimi i shkollës së re në Shtrubullojë pasi që ka nevojë për një objekt të tillë sepse numri i nxënësve është i madh. Ndriçimi publik është projekt që është në realizim e sipër. Vendkalim për këmbësor tek rrethi do të parashihet nga ekspertët e fushës si dhe do të tentohet të bëhet një zgjidhje për mirëmbajtjen e qendrës rinore.</p> | <p>Kapitale</p> |
| | <p>Ndriçim, qerdhe të fëmijëve te shkolla "Halil Bajraktari". Çerdhja do të ndërtohet nga mërgimtarët nëse na ipet leja.</p> | <p>Jahir Beqiri, administrator i Drenas II</p> | <p>Pranohet pjesërisht</p> | <p>Grupi punues njofton se ndriçimi është projekt që po realizohet, kurse sa i përket çerdhës së re është projekt që varet shumë nga niveli qendror sepse është i kufizuar numri i të angazhuarëve nëpër çerdhe nga Ministria e Arsimit.</p> | <p>Kapitale</p> |

KOMUNIA E DRETNASIT

KOMUNIA E DRETNASIT



Eja edhe Ti!



Eja edhe Ti!

DËGJIME BUXHETORE

Dobroshec, Godanc, Gllanasetë, Likoshan, Çikatovë e Vjetër dhe Gradicë

DËGJIME BUXHETORE

Tërstenik I dhe II, Shtuticë, Polluzhë dhe Vërboc

228400014/2022/24
1103300

Pjesëenarës:
Bazakutivi

228400014/2022/24
1103300

Pjesëenarës:
Bazakutivi

Mbshet në: Objektivin e shkollës fillore "Rilindja" në Dobroshec.

Mbshet në: Objektivin e shkollës fillore "Zenel Hajdini" në Tërstenik.

KOMUNIA E DRETNASIT



Eja edhe Ti!

DËGJIME BUXHETORE

Baicë, Tërdec, Abri, Damanak dhe Krajkovë

330400014/2022/24
1103300

Pjesëenarës:
Bazakutivi

Mbshet në: Objektivin e shkollës fillore "Migjeni" në Baicë.

KOMUNA E DRENASIT



Eja edhe TI!

DËGJIME BUXHETORE

Arlat, Gjergjë, Negroç, Llapushnik, Bytyq dhe Vuçak



31 Korrik 2024
18:30

Pjesëmarrës:

Ekzekutivi

Mbëhet në: Objektin e shkollës fillore "Abedin Bujupi" në Arlat.

KOMUNA E DRENASIT



Eja edhe TI!

DËGJIME BUXHETORE

Komoran I, II, III, Zabel i Ulët, Epërm, Korrotçë e Ulët, e Epërme, Fushticë e Ulët, Epërme, Sankoc, Nekoc dhe Kizharkë



31 Korrik 2024
18:30

Pjesëmarrës:

Ekzekutivi

Mbëhet në: Objektin e shkollës fillore "Xheladin Gashi" në Komoran.

KOMUNA E DRENASIT



Eja edhe TI!

DËGJIME BUXHETORE

Drenas I, II, III, Shtrubullovë, Gltobar, Vasilevë, Poklek i Ri dhe i Vjetër



31 Korrik 2024
18:30

Pjesëmarrës:

Ekzekutivi

Mbëhet në: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Komuna e Drenasit,
30.08.2024

Përpiluar nga:
Aydin Mzin – Këshilltar politik

